



Group for Legal  
and Political  
Studies



INSTITUTI GAP

INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY  
INSTITUTI PËR POLITIKË ZHVILLIMORE



Vlerësimi i

# 100 ditëve të para

të Qeverisë



Vlerësimi i

# 100 ditëve të para të Qeverisë

Hyrje 3

Vendimet e 'mëdha' të qeverisë 6

Programi ambicioz legjislativ 13

Mungesa e Diplomacisë 16

(Mos)Transparenca në qeverisje 20

Përfundimi 22

# Hyrje

Kryeministri Ramush Haradinaj është zotuar për përmbushjen e premtimeve të rëndësishme të bëra gjatë fushatës zgjedhore. Pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, formimi i qeverisë ka kërkuar disa negocime të vështira, që dolën të suksesshme vetëm në momentet e fundit. Janë bërë njëqind ditë që kur ia doli të krijojë qeverinë. Andaj, si ka performuar kabineti i tij deri më tani dhe çka do të duhet të presim në të ardhmen?

Para se të hyjmë në vlerësim të 100 ditëshit, ia vlen të përqendrohemi në fushatën, premtimet e dhëna nga Kryeministri dhe partnerët e koalicionit, si dhe strukturën e qeverisë. Zyrtarisht, fushata zgjedhore ka filluar më 31 maj 2017 dhe ka zgjatur vetëm 10 ditë.<sup>1</sup> Për të tërhequr votuesit, shumica e kandidatëve dolën me premtime atraktive për masën, siç janë liberalizimi i vizave, rritja e menjëhershme dhe e madhe e pagave dhe pensioneëve, rivitalizimi i minierave të Trepçës e të tjera.<sup>2</sup> Rezultati i zgjedhjeve ishte i ngushtë; koalicioni PDK, AAK, NISMA dhe një numër i madh i partive më të vogla, i cili filloi të njihet si koalicioni PAN, doli i pari me 33.74% të votave, por pa vota të mjaftueshme për të formuar qeverinë.<sup>3</sup> Vetëvendosje dhe koalicioni i udhëhequr nga LDK (koalicioni LAA) ishin të dytë, gjegjësisht të tretë, kështu duke lënë një koalicion qeverisës pezull. Pas tre muajve ngecje, koalicioni PAN arriti të bind AKR-në, e cila në zgjedhje ishte pjesë e koalicionit LAA, për të hyrë në koalicion qeverisës dhe rrjedhimisht për të zhblokuar ngërçin institucional.

Qeveria që u betua më 9 shtator 2017,

- 1 Misioni i Bashkësisë Evropiane për Vëzhgim të Zgjedhjeve (2017). Raporti Përfundimtar i Zgjedhjeve të Kosovës për Legjislativin 2017. Prishtinë Në dispozicion në: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final\\_report\\_eom\\_kosovo\\_june\\_2017.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_eom_kosovo_june_2017.pdf).
- 2 Kosova Info (2017) "Top premtimet e Ramush Haradinajt, çfarë kishte thënë gjatë fushatës" [Online] Në dispozicion në: <http://www.kosova.info/top-premtimet-e-ramush-haradinajt-çfare-kishte-thene-gjate-fushates/> [Qasur: 30 nëntor 2017].
- 3 Komisioni Qendror Zgjedhor (2017) Rezultatet për Kosovë. Në dispozicion në: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/2.%20Rezultatet%20e%20p%C3%ABrjithshme%20sipas%20Subjekteve%20-%20General%20Results%20by%20Party\\_knawhjqcix.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/2.%20Rezultatet%20e%20p%C3%ABrjithshme%20sipas%20Subjekteve%20-%20General%20Results%20by%20Party_knawhjqcix.pdf).

si rezultat i një kompromisi të vështirë, është mjaft heterogjene. Është e përbërë nga 21 ministri, në të cilat deri më tani janë emëruar mbi 70 zëvendësministra. Krahasuar me qeverinë e fundit, në këtë mandat janë shtuar dy ministri të reja, kurse janë shuar postet e dy ministrave pa portofol, si dhe gati është dyfishuar numri i zëvendësministrave, numri i të cilëve pritet të rritet më tutje.<sup>4</sup>

Kjo qeveri gjigante mund të llogaritet në mesin e qeverive më të mëdha në Evropë, pasi që është e përbërë nga 23 parti dhe një anëtar i pavarur, e cila paraqet një ndryshim të madh nga Qeveria Mustafa. Ajo është e përbërë nga partitë që i takojnë qeverisë së mëparshme, siç janë PDK-ja, Lista Serbe, dy koalicione joserbe, dhe disa parti më të vogla, të shoqëruara nga AAK, NISMA dhe AKR.<sup>5</sup>

- 4 Telegrafi (2014) "Kuvendi voton Qeverinë e re: Ja emrat e Kabinetit Mustafal!" [Online] Në dispozicion në: <https://telegrafi.com/kuvendi-voton-qeverine-e-re-ja-emrat-e-kabinetit-mustafa/> [Qasur: 1 dhjetor 2017]; Radio Evropa e Lire (2017) "Emrat e ministrave të Qeverisë së re të Kosovës" [Online] Në dispozicion në: <https://www.evropaelire.org/a/28726123.html> [Qasur: 1 dhjetor 2017]; Telegrafi (2017) "Sa do të "kushtojë" Qeveria Haradinaj?" [Online] Në dispozicion në: <https://telegrafi.com/sa-te-kushtojte-qeveria-haradinaj/> [Qasur: 2 dhjetor 2017]; Kosova Info (2017) "Haradinaj e shkarkoi një zv. ministër, emëroi menjëherë tre të tjerë" [Online] Në dispozicion në: <http://www.kosova.info/haradinaj-e-shkarkoi-nje-zv-minister-emeroi-menjehere-tre-te-tjere/> [Qasur: 5 dhjetor 2017].
- 5 Komisioni Qendror Zgjedhor (2017) Rezultatet përfundimtare nga QNR: Zgjedhjet per Kuvendin e Kosoves 2017. Prishtine.

PDK, e cila në qeverinë e kaluar ka kontrolluar nëntë ministri, tani ka vetëm gjashtë; ajo ka humbur Ministrinë e Punëve të Jashtme, atë të Zhvillimit Ekonomik, dhe të Arsimit, dhe ka arritur të mbajë Ministrinë e Integritimit Evropian dhe atë të Drejtësisë, derisa fitoi disa dikastere të tjera kyçe, siç janë ai i Financave dhe Shëndetësisë. Ndaj, edhe pse ajo është duke menaxhuar më pak ministri me një buxhet mjaft të reduktuar, ajo tani kontrollon pozitrat kyçe brenda qeverisë, përfshirë buxhetimin, raportet me BE-në dhe administrimin e drejtësisë.

Lista Serbe është një ndër partitë që ka mbajtur ministrinë me të cilat ka udhëhequr në qeverinë e mëparshme dhe ka fituar një ministri më shumë, pas marrjes së drejtimit të Ministrisë së Bujqësisë nga PDK. Duke marrë parasysh që kjo Ministri është një ndër më të mëdhatë në Kosovë, kjo nënkupton fitim të madh të pushtetit, edhe nëse kjo parti mbetet partner i vogël. Partitë e pakicave joserbe mbesin me dy ministri të tjera.

Në qeveri janë të përfaqësuara tri parti të reja: AAK, AKR dhe Nisma, plus ministri i pavarur. Së pari, AAK, me përjashtim të vetë Haradinajt, është duke menaxhuar Ministrinë e Forcave të Sigurisë së Kosovës, dhe atë të Infrastrukturës, e cila është një nga ministrinë me buxhetin më të madh. Së dyti, AKR-, pjesëmarrja e së cilës ka qenë kritike për formimin e qeverisë ka fituar katër ministrinë më prestigjioze; Ministrinë e Punëve të Jashtme, Punëve

të Brendshme, Zhvillimit Ekonomik, dhe atë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Së treti, Nisma kontrollon Ministrinë e Punës, ministrinë me buxhetin më të madh në gjithë qeverinë, si dhe të Arsimit dhe atë të Tregtisë dhe Industrisë, të cilat janë shumë qenësore në kompetenca. Befasia më e madhe ka qenë emërimi i një kandidati të pavarur për Ministër të Diasporës dhe Zëvendëskryeministër, z. Dardan Gashi.

Synimi i kësaj analize politike është ofrimi i një vlerësimi për 100 ditët e para të qeverisë, dhe vlerësimi i performancës së saj bazuar në premtimet dhe programet e saj elektorale, si dhe në Programin Qeverisës 2017-2021 dhe agjendën legjislativë. Kjo do të jetë analiza e parë në serinë e analizave që do pasojnë përgjatë mandatit të Qeverisë Haradinaj. Analiza do të jetë e strukturuar si në vijim: Pjesa II do të sigurojë një analizë të vendimeve të qeverisë dhe përmbajtjes së tyre. Pjesa III do të ofrojë analizë të detajuar të programit legjislativ; më saktësisht, projektligjet e proceduara, të miratuara, si dhe iniciativat e reja legjislativë. Pjesa në vijim do të vë në pah zhvillimet kryesore dhe sfidat që kanë të bëjnë me diplomacinë e Kosovës, njohjet e pavarësisë dhe tërheqjet nga njohja e pavarësisë, anëtarësimin në organizata të ndryshme ndërkombëtare, dhe politikën e jashtme në përgjithësi. Pjesa V do të përqendrohet në nivelin e transparencës treguar nga qeveria gjatë kësaj periudhe në lidhje me të gjitha vendimet e marra deri më tani. Pjesa e fundit do të nxjerr në pah të gjeturat kryesore të studimit.

# Vendimet e 'mëdha' të qeverisë

Kjo pjesë do të shtjellojë vendimet e marra nga Qeveria Haradinaj që nga seanca e parë plenare e mbajtur më 10 shtator 2017. Deri më 18 dhjetor, gjatë 10 ditëve të qeverisë, qeveria ka mbajtur 19 takime dhe ka marrë 202 vendime; mesatarisht 10 vendime janë marrë për çdo takim.

Një javë pas marrjes së detyrës, Qeveria ka miratuar Programin Qeveritar për periudhën 2017-2021 dhe Programin Legjislativ për vitin 2017. Ky i fundit përmban 74 projektligje, shumica të parapara nga qeveria e mëparshme. Nga to, deri më 18 dhjetor janë aprovuar 36 projektligje, përfshirë 3 projektligje të paparashikuara. Për dallim nga programi legjislativ, programi qeverisës as nuk është publikuar e as diskutuar nga Kuvendi, dhe nuk është në dispozicion për publikun pa kërkesë paraprake.

19

takime


—

202

vendime

Në të njëjtën kohë, vetë organogrami i qeverisë mbetet i paqëndrueshëm, pasi që zëvendësministrit emërohen dhe shkarkohen pa ndonjë arsytim të qartë. Nuk janë matur efektet e praktikës së tillë në efikasitetin e departamenteve gjegjëse, por me siguri që nuk mund të konsiderohen pozitive.<sup>6</sup>

Gjatë kësaj periudhe, janë miratuar 8 akte nënligjore, 22 iniciativa ndërkombëtare, kryesisht ato që kanë të bëjnë me kreditë financiare; 9 vendime për shpronësim, 11 shkarkime dhe disa emërimë në bordet e agjencive publike. Qeveria ka ndarë gjithsejtë 3.6 milionë euro nga fondet rezervë. Derisa shumica e këtyre veprimeve të ndërmarra mund të konsiderohen rutinë, janë bërë disa zhvillime dhe iniciativa të rëndësishme të cilat ia vlen të shqyrtohen.



# 3.6 milionë

euro të ndara

<sup>6</sup> Kosova Info (2017) “Haradinaj e shkarkoi një zv. ministër, emëroi menjëherë tre të tjerë” [Online] Në dispozicion në: <http://www.kosova.info/haradinaj-e-shkarkoi-nje-zv-minister-emeroi-menjehere-tre-te-tjere/> [Qasur: 5 dhjetor 2017].

## Shënjimi i kufirit me Malin e Zi

Duke marrë parasysh që kjo çështje ka qenë qenësore në rrëzimin e qeverisë së mëparshme, nuk është befasuese që Qeveria Haradinaj e ka konsideruar këtë si prioritet. Në fakt, në takimin e parë të kabinetit, vendimi i vetëm i marrë ka qenë shkarkimi i gjithë Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, me mbështetje të të gjithë ministrave, me përjashtim të dy ministrave nga Lista Serbe.<sup>7</sup>

Opozita ka kritikuar disa nga vendimet e Haradinajt, duke i konsideruar ato të paligjshme dhe që më shumë shihen si përpjekje për ta treguar forcën sesa për përmbushjen e interesit të përgjithshëm.<sup>8</sup> Në fakt, sipas Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe rregulloren e saj mbështetëse (nr. 17/2013), anëtarët e Komisionit mund të shkarkohen nga qeveria vetëm në këto raste: nëse është i dënuar nga gjykata kompetente, si dhe me kërkesë të institucionit që ka emëruar anëtarët ose vet Komisionit. Asnjë nga këto dispozita nuk janë të zbatueshme në këtë rast për cilindo anëtar të prekur nga ky vendim. Rrjedhimisht, ligjshmëria e këtij vendimi mbetet e dyshimtë, pavarësisht leverdisë së tij politike. Megjithatë, nga fundi i

shtatorit, qeveria ka emëruar anëtarët e rinj të Komisionit dhe i ka caktuar atyre detyrën që të përpilojnë raportin e ri për shënjimin e kufirit me Malin e Zi.<sup>9</sup> Ky raport iu është paraqitur qeverisë për miratim më 4 dhjetor, pas së cilës pritet të diskutohet në Kuvend.<sup>10</sup> Sipas Kryesuesit të Komisionit, ekipi i tij nuk ka qenë përgjegjës për caktimin e kufirit mes Kosovës dhe Malit të Zi, por për ta vlerësuar performancën e Komisionit të mëparshëm. Si pasojë, Kuvendi nuk do të votojë raportin e ri, por atë të mëparshmin.<sup>11</sup>

Sa i përket kësaj, përkundër që u kritikua dhe kundërshtua publikisht nga anëtarët e koalicionit të tij, qasja e zgjedhur nga Haradinaj për trajtimin e kësaj çështjeje tregon që qëllimi i tij ka qenë vetëm të dëshmojë këndvështrimin e tij, duke marrë parasysh që ai ka qenë kundër marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi që në fillim.<sup>12</sup>

7 Vendimi i Qeverisë nr. 01/01, 9 shtator 2017. Në dispozicion në: [www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_Mbledhjes\\_së\\_parë\\_të\\_Qeverisë\\_së\\_Republikës\\_së\\_Kosovës\\_2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_Mbledhjes_së_parë_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2017.pdf)

8 Portali Online (2017) “Shkarkimi i Komisionit të demarkacionit nga kryeministri Haradinaj, akt antiligjor?” [Online] Në dispozicion në: <http://portalionline.com/shkarkimi-i-komisionit-te-demarkacionit-nga-kryeministri-haradinaj-akt-antiligjor/>. [Qasur: 4 dhjetor 2017].

9 Vendimi i Qeverisë nr. 01/04, 22 shtator 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_së\\_4-të\\_të\\_Qeverisë\\_së\\_Republikës\\_së\\_Kosovës\\_2017..pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_së_4-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2017..pdf)

10 Klan Kosova (2017) “Raporti i plotë i Shpejtim Bulliqt për demarkacionin (DOKUMENT)” [Online] Në dispozicion në: <http://klankosova.tv/raporti-i-plate-i-shpejtim-bulliqt-per-demarkacionin-dokument/> [Qasur: 8 dhjetor 2017].

11 Koha Net (2017) “Bulliqi: Nuk votohet raporti ynë, votohet ai i ish-komisionit shtetëror” [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/61680/bulliqi-nuk-votohet-raporti-ynë-votohet-ai-i-ish-komisionit-shtetëror/> [Qasur: 7 dhjetor 2017].

12 Kosova Sot (2017) “PDK-ja ia përgatit “kulaçin” Haradinajt” [Online] Në dispozicion në: <http://kosova-sot.info/lajme/230594/pdk-ja-ia-pergati-tit-quot-kulacin-quot-haradinajt/> [Qasur: 5 dhjetor 2017].



Edhe pse Kuvendi do të diskutojë për raportin e ri, Marrëveshja veçse e nënshkruar me Malin e Zi prapë se prapë do t'i nënshtrohet procedurës së votimit. Nëse Kuvendi vendos që të ndryshojë gjithë marrëveshjen bazuar në informatat e reja të siguruar nga raporti i komisionit të ri, atëherë duhet të mbahen diskutime paraprake mes Kosovës dhe Malit të Zi. Megjithatë, ende nuk është e sigurt se si do të veprojë qeveria me këtë çështje, kështu duke shkaktuar konfuzion të mëtutjeshëm për publikun e përgjithshëm.

## Shkarkimi i anëtarëve të disa bordeve të agjencive të pavarura

Në përpjekje për të depolitizuar bordet e ndërmarrjeve publike, në takimin e saj të 5-të, Qeveria ka vendosur të shkarkojë 10 nga 19 anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike, të cilët ishin cekur në raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit si mbajtës të paligjshëm të detyrës. Opinioni i AKK konkludoi që procesi i emërimit është në kundërshtim me Ligjin nr. 03 / L-087 për Ndërmarrjet Publike, i cili ndalon emërimin e individëve të cilët mbajnë pozita në parti politike ose të cilët kanë kandiduar në zgjedhje për pozita në tri vitet e fundit.<sup>13</sup>

Sidoqoftë, sado që mund të duket ky vendim për t'u përgëzuar, ai krejtësisht dështon të adresojë rrënjën e problemit, përkatësisht politizimin e këtyre bordeve.

13 Vendimi i Qeverisë nr. 06-15/05, 29 shtator 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_s%C3%AB\\_5-t%C3%AB\\_1%C3%AB\\_Qeveris%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Republik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs\\_2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_5-t%C3%AB_1%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2017.pdf)

Ekzistojnë dy arsye kryesore që e bëjnë këtë vendim të politizuar dhe si i tillë përfaqëson zbatimin e pjesshëm të ligjit. Së pari, për anëtarët e disa bordeve (siç janë KOSTT apo AAK) Kuvendi është përgjegjës për shkarkimin e këtyre individëve, jo Qeveria. Së dyti, ekzistojnë procedura të veçanta ligjore që duhet ndjekur për të zëvendësuar personat e shkarkuar. Prandaj, procedurat e ndjekura nga qeveria për të prekur këtë çështje kanë injoruar dhe nuk kanë marrë parasysh këto dy pika.<sup>14</sup>

## Falja e borxheve për ambalazhuesit e ujit

Në fillim të tetorit, Qeveria ka marrë vendim të falë borxhet që nga viti 2008 për të gjithë ambalazhuesve të ujit. Ky borxh kundrejt buxhetit të Kosovës arrin shumën deri në 51 milion euro.<sup>15</sup> Ky vendim mund të konsiderohet i paligjshëm, i padrejtë, dhe i dëmshëm në baza të ndryshme.<sup>16</sup>

Pikë së pari, burimet e ujit konsiderohen

14 Organizata e pavarur Gap dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (2017) "Kërkesa për të rishikuar vendimin për zbatimin e pjesshëm të Mendimit të Agjencisë Kundër-Korrupsionit për depolitizimin e bordeve të Ndërmarrjeve Publike". Në dispozicion në: [http://indep.info/wp-content/uploads/2017/10/letter\\_to\\_prime\\_minister-1.pdf](http://indep.info/wp-content/uploads/2017/10/letter_to_prime_minister-1.pdf)

15 Vendimi i Qeverisë nr. 13/06, 3 tetor 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_s%C3%AB\\_6-t%C3%AB\\_1%C3%AB\\_Qeveris%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Republik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs\\_2017..pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_6-t%C3%AB_1%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2017..pdf)

16 Organizata e pavarur Gap dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (2017) "Falja e borxheve nuk mund të bëhet pa aprovimin e Kuvendit të Kosovës". Në dispozicion në: <http://indep.info/sq/falja-e-borxheve-nuk-mund-te-behet-pa-aprovimin-e-kuvendit-te-kosoves/>

pronë e Republikës së Kosovës, si dhe pasuri që shërbejnë për interesin e përgjithshëm.<sup>17</sup> Në momentin që ky vendim i shërben vetëm interesit të një grupi të vogël, ai është në kundërshtim me këtë parim. Së dyti, ai shkel parimet që sipas Ligjit për ujërat, duhet të drejtojnë veprimet e institucioneve. Këto parimet janë “shfrytëzuesi paguan” dhe pjesëmarrja e palëve të interesit. Së treti, neni 6, paragrafi 7 i Ligjit për ujërat, thotë se “shfrytëzuesi i ujit, do t’i paguajë të gjitha shpenzimet të cilat dalin nga ofrimi i shërbimeve në të cilat do të jenë të përfshira edhe shpenzimet e resurseve ujore për shfrytëzim, si dhe shpenzimet për mjedisin”. Sa i përket të fundit, që rrjedh nga paragrafi II i të njëjtit nen, ai obligon institucionet të marrin parasysh interesin e të gjitha palëve të interesit kur bëjnë miratimin e dispozitave, dokumenteve strategjike, programeve, dhe vendimeve.<sup>18</sup>

Prandaj, vendimi për faljen e borxheve për shpërndarësit e ujit nuk është vetëm i paarsyetuar, por ai gjithashtu përçon porosi negative dhe të padëshirueshme tek sektori privat, duke krijuar pritshmëri për falje të mëpasshme të taksave, kështu duke dëmtuar buxhetin e shtetit. Si pasojë, një vendim i tillë duhet të miratohet vetëm nga Kuvendi. Jo vetëm që Kuvendi është shpërfillur i tëri, por gjithashtu asnjë procedurë e brendshme qeveritare nuk është pasuar siç duhet. Siç edhe është pranuar nga vet Kryeministri, ky vendim është marrë përmes një procedure të përshpejtuar pa

asnjë vlerësim normativ nga Ministria e e Financave apo ajo e Mjedisit.

## Kompensimi për Deputetët e legjislaturës së 1990-tave

Qeveria ka marrë vendim për të ofruar një kompensim të një hershëm për 111 individë, ose pasuesit e tyre, aty ku është e zbatueshme, të cilët kanë shërbyer në Kuvendin që ka shpallur pavarësinë nga Serbia në vitin 1990, si kompensim për sakrificat e tyre. Ky vendim, sipas Kryeministrit, konsiderohet si obligim moral dhe plotësim i së drejtës së vonuar.<sup>19</sup> Vendimi është përshëndetur nga disa individë të prekur nga ky vendim, të cilët deklaruan që ata janë mirënjohës për këtë kompensim pasi që disa nga ata janë duke u ballafaquar me probleme të rënda shëndetësore dhe kanë mungesë të mjeteve financiare.<sup>20</sup> Në këtë frymë, kompensimi mund të perceptohet si mirënjohje ndaj një grupi të individëve që kanë qenë të angazhuar dhe të përkushtuar ndaj vendit dhe popullit të tyre në një epokë shumë të rrezikshme, ku secili nga ta do të mund të arrestohej. Për më tepër, ky vendim mund gjithashtu të konsiderohet si një njohje e kontributit të tyre për inicimin e procesit të shtet-ndërtimit të Kosovës.

19 Vendimi i Qeverisë nr. 04/13, 10 nëntor 2017.

Në dispozicion në:  
[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_s%C3%AB\\_13-1%C3%AB\\_1%C3%AB\\_Qeveris%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Republik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs\\_2017...pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_13-1%C3%AB_1%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2017...pdf)

20 Index Online (2017) “Delegatët e 2 korrikut i gëzohen vendimit të Qeverisë” [Online] në dispozicion në:  
<http://indeksonline.net/old/en/news/delegatet-e-2-korrikut-i-gezohen-vendimit-te-qeverise-146361> [Qasur: 1 dhjetor 2017].

17 Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 1.

18 Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 6 (1.7 dhe 1.11). në dispozicion në:  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>

## Kompensimi për familjet e të përfshirëve në Kumanovë

Ky vendim i marrë në të njëjtin takim ku u mor edhe vendimi i mëparshëm, ndjek një strukturë të ngjashme. Ajo synon familjet e atyre qytetarëve të Kosovës të përfshirë në luftimet dy ditore, përfshirë ata që kanë vdekur dhe ata të dënuar nga gjykatat maqedonase. Secila familje do marrë 10,000€ si kompensim, duke arritur kështu shumën totale prej 290,000€. <sup>21</sup>

Kompensimi i individëve që kanë marrë pjesë në një konflikt jashtë vendit është i pamatur, pasi që një qëndrim i tillë shkel Ligjin Nr. 05/L-002 për ndalimin e pjesëmarrjes në konflikte të armatosura jashtë territorit, pavarësisht lidhshmërisë që kauza e tyre mund të sjellë. Rrjedhimisht, për të gjitha qëllimet, Qeveria përmes vendimeve të veta, është duke shpërblyer atë që nënkupton kryerjen e një veprë të paligjshme sipas ligjeve kosovare. Për më tepër, duke marrë parasysh situatën delikate politike në Maqedoni dhe faktin që gjykatat maqedonase kanë gjykuar këta individë si terroristë kur kanë sjellë vendimin e dënimit të tyre, ky vendim ka potencial të madh për të destabilizuar marrëdhëniet me vendet fqinje, edhe nëse ky nuk ka qenë qëllimi i tij fillestar. Edhe njëherë, trajtimi i çështjeve ndërkombëtare si diçka krejtësisht të brendshme paraqet një

sjellje të papërgjegjshme dhe të pamatur që vetëm se dërgon porosi të përziera tek qeveritë e vendeve fqinje.

## Caktimi i fondeve publike për trajtim mjekësor jashtë vendit të disa figurave publike

Më 4 dhjetor, Qeveria është pajtuar që të caktojë €30,000 për të mbuluar kostot e trajtimit të z. Bujar Bukoshit, ish-Ministër i Shëndetësisë dhe një nga themeluesit e LDK-së, gjendja e të cilit e ka detyruar të kërkojë trajtim jashtë vendit. <sup>22</sup> Derisa vet vendimi i ofrimit të trajtimit më të mirë të mundshëm të një qytetari nuk është i dënueshëm si i tillë, ai sjell shtrimin e pyetjes së trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët.

Më saktësisht, derisa meritat e rastit të z. Bukoshi nuk vihen në dyshim, mbetet fakti që ky vendim nuk ka bazë ligjore dhe është veprim mirësie, derisa mijëra qytetarë tjerë kosovarë do të mund të përfitonin nga lloji i asistencës së njëjtë. Ka mospajtime se fakti që sigurimi i kujdesit të shtrenjtë shëndetësor jashtë vendit për figura të caktuara që kanë lidhje me politikën, derisa shpërfillen nevojat e popullatës së gjerë, vetëm se përkeqëson pabarazitë në Kosovë. Si rrjedhojë, më së paku që do të duhej të bëhej është që një vendim i tillë duhet të jetë i bazuar në kritere objektive, të specifikuar më parë e që janë të arritshme për të gjithë.

21 Vendimi i Qeverisë nr. 09/13, 10 nëntor 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendi-met\\_e\\_Mbledhjes\\_s%C3%AB\\_13-t%C3%AB\\_t%C3%AB\\_Qeveris%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Repub-lik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs\\_2017...pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendi-met_e_Mbledhjes_s%C3%AB_13-t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Repub-lik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2017...pdf)

22 Vendimi i Qeverisë nr. 02/18, 6 dhjetor 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendi-met\\_e\\_Mbledhjes\\_s%C3%AB\\_18-t%C3%AB\\_t%C3%AB\\_Qeveris%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Repub-lik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs\\_2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendi-met_e_Mbledhjes_s%C3%AB_18-t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Repub-lik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2017.pdf)

## Marrja parasysh e një statusi të veçantë për Haden dhe Shipitullën

Fshatrat Hade dhe Shipitullë shtrihen mbi shtresat e qymyrit, nxjerrja e të cilit pritet të fillojë së shpejti. Sidoqoftë, kjo do të kërkojë shpronësimin dhe ri-caktimin e banorëve lokal, një akt që mund të shkaktojë rezistencë në të dyja fshatrat. Për ta tejkaluar këtë, Qeveria duhet të ndër marrë disa veprime. Në një rën anë, për të kënaqur pronarët e tokave, ajo ka rishikuar metodën e llogaritjes së kompensimit gjatë procesit të shpronësimit. Në anën tjetër, ajo i ka dhënë prioritet banorëve të të dyja fshatrave për të qenë pjesë e cilësdo mundësi punësimi që del nga nxjerrja e thëngjillit dhe prodhimit të rrymës.<sup>23</sup>

Këto vendime të qeverisë ia dolën që të zgjidhin shpronësimin problematik të pronës së banorëve, e cila është shtyrë për disa vite. Megjithatë, duke i dhënë prioritet punësimit të individëve që banojnë në atë zonë, Qeveria krijon një situatë të padrejtë duke privuar individët e tjerë të cilët janë të kualifikuar dhe me përvojë të kenë qasje të drejtë në këto mundësi punësimi.

## Vërejtje të përgjithshme

Kjo përzgjedhje e temave tregon dy gjëra: e para, që prioritetet e Kryeministrit dhe kabinetit të tij nuk kanë përkuar me premtime parazgjedhore. Kosova nuk është më afër fitimit të regjimit të lirë nga vizat nga BE-ja dhe as nuk janë rritur ndjeshëm pensionet dhe rrogat. Në fakt, këto premtime, siç është edhe ajo e Trepçës, deri më tani as që janë marrë parasysh. Së dyti, kjo tregon që qeveria më shumë vepron sipas impulseve dhe kërkon vëmendjen e medieve sesa që punon me qëllim strategjik dhe qeverisje të mirë në mendje. Nga 7 çështjet e vëna në pah, 2 kanë qenë të paktën të pabazuara dhe 4 kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nëse kjo shërben si shtysë në këtë mandat, duke miratuar vendime të papeshuara, pa konsultime të duhura dhe duke shpërfillur krejtësisht autoritetin e institucionit të thirrur për t'i marrë ato, atëherë kjo nuk është shenjë e mirë për të ardhmen e Kosovës. Nxitimi i Qeverisë për të marrë vendime pa i shqyrtuar është i prirë të vazhdojë nëse nuk kontrollohet shpejt.

<sup>23</sup> Vendimi i Qeverisë nr. 04/02, 15 shtator 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_dyte\\_Qeveris%C3%AB.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_dyte_Qeveris%C3%AB.pdf)

# Programi ambicioz legjislativ

Qeveria Haradinaj ka miratuar programin e ri legjislativ në pjesën e vonshme të shtatorit, pak pas ardhjes në pushtet, i cili është ndryshuar një muaj më vonë. Ky program përmban 74 projektligje të cilat priten të procedohen deri në fund të vitit. Nga këto, 50 (67.56 për qind) janë të trashëguara nga qeveria e mëparshme, ndërsa vetëm 24, ose 32.43 për qind janë iniciativa të reja legjislative. Deri më tani, nga 74 projektligje të parapara, 33 (44.59 për qind) janë dërguar në Kuvend për t'u diskutuar. Pra, qeveria ka dështuar në procedimin e 26 nga 41 projektligjet tjera, të cilat janë jashtë afatit kohor të përcaktuar në program. Vlen të theksohet se 15 projektligjet e tjera janë të planifikuara të procedohen pas datës 18 dhjetor deri në fund të vitit. Për më tepë, projektligji për Prokurorin e Shtetit, Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), Ratifikimin e Marrëveshjes së Kufirit Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të cilat nuk janë paraparë nga programi i tanishëm legjislativ, janë propozuar nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Administratës Publike, dhe gjegjësisht nga Ministria e Punëve të Jashtme, dhe janë proceduar në Kuvend për t'u diskutuar.

Pasi dy të tretat e programit legjislativ janë trashëguar nga ai i mëparshmi, ky program nuk përmban ndonjë risi. Disa nga projektligjet qenësore të cilat kanë dështuar të procedohen nga qeveria e mëparshme, janë hedhur tërësisht. Në mesin e të tjerave janë projektligjet për promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve

të tyre, fondeve investuese, provimit të jurisprudencës, pronës publike, mbrojtjen nga zjarri, zjarrfikësit dhe shpëtimin, kontestet administrative, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen nga zhurmat.

Sa i përket të arriturave institucionale, Zyra e Kryeministrit ka arritur të procedojë 4 nga 10, ose 40 për qind të projektligjeve të parapara për këtë vit; me 2 të tjera që kanë mbetur prapa afatit të planifikuar dhe 4 më shumë që pritet të dërgohen në Kuvend deri në fund të vitit. Deri më tani, Zyra e Kryeministrit i ka dhënë prioritet më të lartë çështjeve të ndryshme, të rëndësishme siç janë liria e religjionit ose harmonizimi i akteve normative; të tjerat shumë më pak të rëndësishme, siç është ndryshimi i ligjit për presidentin për zgjatjen për tërë jetën të dispozitës që ka të bëjë me hapësirën e punës dhe personelit pasi që lënë detyrën. Ende nuk iu është dhënë prioriteti i tillë dokumenteve të tjera, siç janë ajo për mbrojtjen e fëmijëve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ministria e Financave i ka tejkaluar me performancë të tjerët me 90 për qind (9/10) shkallë të suksesit të procedimit të projektligjeve, përfshirë ndryshimin e buxhetit të tanishëm dhe parashikimin për vitin tjetër. Ministria e Integritimit Evropian ia ka dalë me sukses të miratoi një marrëveshje të IPA-së me BE-në nga Kuvendi, i vetmi veprim i paraparë nga programi legjislativ, dhe i cili në qeverinë e mëparshme veçse është tentuar, por pa sukses. Është e rëndësishme të ceket që Ministria e Drejtësisë ka qenë e shpejtë në dërgimin e projektligjeve

për diskutim në Kuvend. Më saktësisht, deri më tani ata kanë proceduar 7 nga 12 projektligjet, ose 58.3 për qind; 5 të mbeturat janë planifikuar të dërgohen gjatë javës së fundit të dhjetorit. Të gjitha këto projektligje të mbetura pezull veçse kanë qenë në programin e mëparshëm legjislativ. Përveç Kodit të ri Civil, të gjitha të tjerave iu ka tejkaluar afati për aprovim që në shtator; derisa të tjerat janë programuar nga qeveria e re, edhe pse ministria veçse ka filluar të punojë me to qysh në mandatin e mëparshëm.

Për më tepër, Ministria e Punëve të Brendshme ka demonstruar një nivel të efikasitetit prej 60 për qind (3/5), më së shumti që kanë të bëjnë me bartjen e udhëzimeve në fushën e kontrollit të kufijve, shtetasve të huaj dhe azilit; 40 përqindëshi tjetër është prapa afatit të përcaktuar. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është propozuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe është proceduar tek Kuvendi, edhe pse nuk ka qenë i paraparë me programin legjislativ. Vetëm 71.4 për qind (5/7) e projektligjeve në juridiksionin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kanë qenë të proceduara deri më tani. 2 të pa proceduarat kanë mbetur prapa afatit të caktuar. Të gjitha ato veçse janë projektuar në mandatin e fundit, dhe kështu deri më tani prioritet iu është dhënë atyre që kanë rezultuar nga implementimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ngjashëm, Ministria e Punës ka qenë e ngadaltë në veprim. Nga 3 projektet në vazhdim e sipër, vetëm 1 projektligj për Ndërmarrjet Shoqërore i është

dërguar Kuvendit dhe 2 të tjerat janë prapa afatit. Ministria e Administratës Publike ka proceduar një projektligj të paparapërë për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike; sidoqoftë, ajo ka dështuar në procedimin e ligjit të vetëm të përfshirë në programin legjislativ. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në 100 ditët e saj të para ka proceduar 1 projektligj, ka dështuar ta procedojë tjetrin, dhe pritet që të procedojë 1 tjetër deri në fund të dhjetorit. Për më tepër, vetëm 2 projektligje në juridiksionin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë qenë të parapara me program legjislativ, nga të cilat vetëm 1 që ka të bëjë me statusin e Prishtinës si kryeqytet është proceduar, derisa tjetri pritet që t'i dërgohet Kuvendit gjatë javës së fundit të dhjetorit.

Së fundmi, në mesin e Ministrive më pak të suksesshme në procedimin e projektligjeve është ajo e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Më saktësisht, vetëm 2 nga 8 projektligjet janë proceduar, 4 të pa proceduara janë ato që kanë mbetur prapa afatit të paparapërë, dhe 2 pritet të procedohen deri në fund të dhjetorit. Performancë të dobët gjithashtu ka treguar edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik pasi që ajo ja ka dalë të procedojë vetëm 1 nga 4 projektligjet e projektuara. 3 të tjerat kanë kaluar afatin e paparapërë me program. Megjithatë, ministrinë që deri më tani kanë qenë të pasuksesshme në dërgimin e cilitdo projektligj në Kuvend për diskutime të mëtutjeshme përfshijnë Ministrinë e Shëndetësisë,

Forcave të Sigurisë. Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe atë të Diasporës. Sidoqoftë, është planifikuar që disa nga projektligjet që kanë të bëjnë me këto Ministri të zënë vend gjatë dy javëve të fundit të vitit.

## Vërejtje të përgjithshme

Në përgjithësi, mund të thuhet që Qeveria nuk ka qenë në gjendje të mbajë ritmin me planifikimin e vet, edhe pse ajo nuk ka performuar më keq sesa qeveria e mëparshme e Mustafës. Në fakt, pjesa dërrmuese e projektligjeve që janë miratuar dhe dërguar në Kuvend janë rezultat i punës së filluar gjatë mandatit të mëparshëm, që në shumicën e rasteve ka ngecur në intervalin mes pushtetit të të dy qeverive, me shumë pak iniciativa origjinale. Siç u tha, Qeveria e re ka zgjedhur ta ruajë vazhdimësinë në fushën legjislative në vend që të refuzoj plotësisht projektet e vjetra ose të prezantoj ndryshime radikale.

# Mungesa e Diplomacisë

Për shkak të situatës së veçantë të njohjeve të kufizuara të Kosovës, mund të argumentohet që zhvillimi i një diplomacie të suksesshme është e rëndësishme madhore për vendin. Sigurimi i njohjeve nga sa më shumë shtete anëtare të KB-ve që është e mundur dhe pjesëmarrja në forume ndërkombëtare është kritike për t'i dhënë fund izolimit me të cilin përballemi tani. Për këtë qëllim, performanca e Ministrisë së Punëve të Jashtme duhet të jetë e sigurtuar në çdo kohë, dhe cilido intervenim në këtë çështje nga institucionet e tjera duhet të bëhet për qëllime të njëjta. Kështu, planifikimi strategjik dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve janë edhe më kritike në këtë fushë.

Në këtë frymë, Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, gjatë 100 ditëve të tij të para ka pranuar dhe ka bërë disa vizita, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Më saktësisht, ai ka mirëpritur Zëvendëskryeministrin Maqedonas për Çështje Evropiane, Ambasadorët e Norvegjisë dhe atë Belg, dhe në mesin e të tjerëve Kreun e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Gjatë takimeve të tyre, ata kanë shkëmbyer përvojat që kanë të bëjnë me proceset e integritimit, anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, liberalizimin e vizave, dhe rritjen e bashkëpunimit bilateral në sfera të ndryshme.<sup>24, 25</sup>

Në anën tjetër, në mesin e vendeve

24 Koha Net (2017) "Norvegjia e interesuar të thellojë bashkëpunimin me Kosovën" [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/48509/norvegjia-e-interesuar-te-thelloje-bashkepunimin-me-kosoven/> [Accessed: 7 dhjetor 2017].

25 Koha Net (2017) "Kosova kërkon përkrahje nga Belgjika" [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/49881/kosova-kerkon-perkrahe-nga-belgjika/> [Qasur: 15 dhjetor 2017].



të tjera, Ministri ka vizituar Francën, Slloveninë, Shtetet e Bashkuara, Maltën, dhe Maqedoninë. Gjatë këtyre vizitave ai u takua me presidentët, kryeministrat, krerët e Kuvendeve, dhe në mesin e të tjerëve homologët e tij. Vlen të ceket që ai ka treguar mirënjohje për mbështetjen e këtyre vendeve gjatë proceseve të integrimit dhe proceseve të tjera të rëndësishme, dedikimin për të nënshkruar memorandume të mirëkuptimit, dhe me mirësjellje ka kërkuar për mbështetjen e mëtutjeshme për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Interpol, UNESCO, dhe organizatat e tjera, dhe përforcimin e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës përmes njohjeve të reja.<sup>26</sup>

Në anën tjetër, kryeministri në 100 ditët e para të tij, ka bërë shumë vizita të ndryshme jashtë vendit, përfshirë dy takime në Shqipëri, njëra nga të cilat ka qenë takim i përbashkët i qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë, dhe ato që kanë zënë vend në Bruksel me Përfaqësuesen e Lartë të Bashkësisë Evropiane për

Marrëdhënie të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, dhe kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor.<sup>27, 28</sup>

Një raport shqetësues doli nga takimi që Haradinaj kishte me Federica Mogherinin, Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Çështje të Jashtme, në Bruksel më 17 nëntor. Sipas burimeve të caktuara, takimi ishte i tensionuar dhe se Mogherini kishte lëshuar sallën pasi që Kryeministri kishte kërkuar të përshpejtohej i ashtuquajtur i liberalizim i vizave dhe kishte sugjeruar që SHBA-të të ftoheshin të merrnin pjesë në Dialogun me Serbinë si lehtësuese. Të dy këto deklarime, sipas këtyre burimeve, do të pranoheshin keq në Bruksel. Ndonëse kjo nuk mund të konfirmohej në atë kohë, është e vërtetë se një konferencë e përbashkët që duhej të mbahej pas takimit u anulua papritmas nga autoritetet e BE-së. Nëse kjo del të jetë e vërtetë, do të ishte tregues i një keqmenaxhimi flagrant të situatës nga Kryeministri, i cili vetë do të kishte krijuar një konflikt diplomatik aty ku nuk kishte kurrfarë konflikti.<sup>29</sup>

26 Koha Net (2017) “Pacolli shkoi në SHBA, merr pjesë në një konferencë të Këshillit Atlantik” [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/60169/pacolli-shkoi-ne-shba-merr-pjese-ne-nje-konference-te-keshillit-atlantik/> [Qasur: 13 dhjetor 2017]; Koha Net (2017) “Pacolli vizitë zyrtare në Slloveni, nis takimet me homologun e tij slloven” [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/64441/pacolli-vizite-zyrtare-ne-slloveni-nis-takimet-me-homologun-e-tij-slloven/> [Qasur: 20 dhjetor 2017]; Koha Net (2017) “Pacolli në Paris, takon disa homologë në konferencën e Frankofonisë” [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/59740/pacolli-ne-paris-takon-disa-homologe-ne-konferencen-e-frankofonise/> [Qasur: 20 dhjetor 2017]; Koha Net (2017) “Pacolli pritet nga presidentja e Maltës, i kërkon mbështetje” [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/54609/pacolli-pritet-nga-presidentja-e-maltes-i-kerkon-mbeshtetje/> [Qasur: 14 dhjetor 2017].

27 Zëri (2017) “100 ditë të qeverisjes Haradinaj (Video)” [Online] Në dispozicion në: <http://zeri.info/aktuale/176163/100-dite-te-qeverisjes-haradinaj-video/> [Qasur: 20 dhjetor 2017].

28 Telegrafi (2017) “Haradinaj udhëton për në Bruksel” [Online] Në dispozicion në: <https://telegrafi.com/haradinaj-udheton-per-ne-bruksel/> [Qasur: 20 dhjetor 2017].

29 Koha Net (2017) “Blic” ‘zbulon’ prapaskenat e takimit të tensionuar mes Haradinajt e Mogherinit” [Online] Në dispozicion në: <http://www.koha.net/arberi/58237/blici-zbulon-prapaskenat-e-takimit-te-tensionuar-mes-haradinajt-e-mogherinit/> [Qasur: 30 nëntor 2017]; Bota Sot (2017) “Zbulohet arsyeja e anulimit të konferencës, Mogherini e ka lëshuar e nervozuar takimin me Haradinajn” [Online] Në dispozicion në: <http://www.botasot.info/lajme/790886/zbulohet-arsyeja-e-anulimit-te-konferences-mogherini-e-ka-leshuar-e-nervozuar-takimin-me-haradinajn/> [Qasur: 1 dhjetor 2017]; Zëri (2017) “Mogherini e ka lëshuar e

Në anën tjetër, Qeveria ka organizuar dhe menaxhuar me sukses vizitën shtetërore të Zoran Zaev, Kryeministrit të Maqedonisë, gjatë së cilës janë diskutuar një varg çështjesh me rëndësi të ndërsjellë, siç janë tregtia bilaterale dhe autostrada e re mes Prishtinës dhe Shkupit. Për më tepër, të dy kryeministrit u pajtuan për hapjen e një hetimi ndërkombëtar në rastin e Kumanovës për të siguruar filtrimin e duhur të përgjegjësive.<sup>30</sup> Ndjeshmëria e rastit si për publikun maqedonas ashtu edhe atë kosovar kërkon që çështja të trajtohet me kujdesin më të madh. Kjo qasje vjen si zhvillim i mirëpritur pas retorikës së mëhershme konfrontuese.

Përkritazi me çështjen e njohjeve, Ministria e Punëve të Jashtme të Madagaskarit konfirmoi krijimin e raporteve diplomatike me Kosovën përmes llogarisë në Twitter kah fundi i nëntorit, gjë që u njoftua edhe nga homologët e tyre kosovarë, duke shtuar numrin e njohjeve në 115.<sup>31</sup> Kjo ngjarje mund të

konsiderohet si mjaft e suksesshme pasi që Serbia ishte angazhuar në një ofensivë të vërtetë diplomatike për ta parandaluar atë.<sup>32</sup> Mediat serbe çuditërisht raportuan se dy vende të ndryshme, Guinea Bissau dhe Surinami kishin vendosur ta tërhiqnin njohjen e Kosovës. Kjo lëvizje do të ishte e paprecedent dhe në kundërshtim me të gjitha praktikatat e pranuar të së Drejtës Ndërkombëtare. Nuk është e qartë nëse dikush mund ta çnjohë një vend duke dërguar një notë diplomatike Ministria e saj për Punë të Jashtme pa ndonjë justifikim të shëndoshë e të arsyeshëm. Mirëpo Qeveria deklaroi se në të drejtën ndërkombëtare nuk ekziston koncepti i tërheqjes së njohjes e as një shtet i quajtur “Kosovë e Metohi” siç theksohet në letrën e zbuluar nga Serbia, kështu që ata nuk kanë pranuar kurrfarë letre zyrtare nga asnjë vend që konfirmon tërheqjen e njohjes së tyre.<sup>33</sup>

Pas kësaj deklarate, me gjithë takimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe lobimin e pareshtur nuk u arritën rezultate të frytshme. Kosova vazhdoi të dështojë në kërkesën e saj për qasje në një varg organizatash ndërkombëtare, mes tjerash Interpol, UNESCO dhe OBT. Në të kaluarën, aplikacioni i Kosovës në Interpol është refuzuar dy herë dhe në shtator ajo tërhoqi një kërkesë të re për të shmangur edhe një refuzim, pasi që,

---

nervozuar takimin me Haradinajn” [Online]

Në dispozicion në:  
<http://zefti.info/aktuale/172284/mogherini-e-ka-leshuar-e-nervozuar-takimin-me-haradinajn/> [Qasur: 30 nëntor 2017].

- 30 Prishtina Insight (2017) “Kryeministri maqedonas viziton Kosovën, paralajmëron hetim ndërkombëtar për rastin e Kumanovës” [Online] Në dispozicion në:  
<http://prishtinainsight.com/macedonian-pm-visits-kosovo-announces-international-investigation-kumano/> [Qasur: 15 dhjetor 2017].

- 31 Ministria e Punëve të Jashtme e Madagaskarit. ‘Letër diplomatike për Behgjet Pacollin’: Antananarivo, 24 nëntor 2017; Telegrafi (2017) “Madagaskari konfirmon njohjen e Kosovës (Foto)” [Online] Në dispozicion në:  
<https://telegrafi.com/madagaskari-konfirmon-njohjen-e-kosoves-foto/> [Qasur: 30 nëntor 2017]; Ministria e Punëve të Jashtme. “Lista e Njohjeve”. Në dispozicion në:  
<http://www.mfa-ks.net/?page=1,259>.

- 32 Gazeta Express (2017) “Njohja e Kosovës nga Madagaskari, kryelajm në mediat serbe” [Online] Në dispozicion në:  
<http://www.gazetaexpress.com/lajme/njohja-e-kosoves-nga-madagaskari-kryelajm-ne-mediat-serbe-466507/> [Qasur: 7 dhjetor 2017].

- 33 Balkan Insight (2017) “Kosova thekson se Surinami nuk mund ta tërheqë njohjen e pavarësisë” [Online] Në dispozicion në:  
<http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-claims-suri-name-cannot-revoke-independence-recognition-10-31-2017> [Qasur: 11 dhjetor 2017].

sipas Haradinajt, Kosova nuk ishte në gjendje të siguronte numrin e nevojshëm të votave.<sup>34</sup> Në të njëjtën kohë, KM njoftoi për një lëvizje të ngjashme në lidhje me UNESCO, kërkesë e cila hasi në kundërshtim të rreptë nga Serbia.<sup>35</sup> ‘Lëvizja taktike’ e Haradinajt mund të konsiderohet e kuptueshme; nuk është rationale të shpërdorohet aq shumë kapital politik duke qenë të sigurt se kërkesa për anëtarësi është e prirë të dështojë. Në anën tjetër, vendimi do të ketë pasoja praktike për vendin. Duke mos qenë pjesë e Interpolit institucionet e sundimit të ligjit nuk janë në gjendje të bashkëpunojnë plotësisht me shumicën e vendeve të tjera anëtare për çështje të sigurisë, duke qenë të shtyra të mbështeten në raporte bilaterale, ndërsa anëtarësimi në UNESCO do të krijonte qasje në shumë programe dhe projekte kulturore me efekte të drejtpërdrejta ekonomike.

## Vërejtje të përgjithshme

Në përgjithësi, ndonëse janë mbajtur takime të ndryshme nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe nga Kryeministri, nuk janë arritur rezultate konkrete në aspekt të diplomacisë. Është regjistruar vetëm një njohje e pavarësisë, krahas dy pretendimeve të tërheqjeve të dyshimta të njohjes të cilat janë mohuar plotësisht nga Qeveria. Kjo e fundit nuk ia ka dalë gjatë 100 ditëve të para të saj të ndërmarrë një qasje proaktive në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si Interpol dhe UNESCO. Si pasojë, madje edhe gati një dekadë pas shpalljes së pavarësisë, ne vazhdojmë të mbesim të përjashtuar nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare të sigurisë. Lobimi i mirëfilltë nga Qeveria është i rëndësishëm parësor me mënyrë që të mund të anëtarësohemi në këto organizata.

34 Balkan Insight (2017) “Kosova heq dorë nga kërkesa për anëtarësim në Interpol këtë vit” [Online] Në dispozicion në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-abandons-bid-to-join-interpol-this-year-09-21-2017> [Qasur më 12 dhjetor 2017].

35 Gazeta Express (2017) “Kosova heq dorë nga kërkesa për anëtarësim në UNESCO” [Online] Në dispozicion në: <http://www.gazetaexpress.com/en/news/kosovo-gives-up-bid-to-join-unesco-173051/> [Qasur: 15 dhjetor 2017].



1

njohje e  
pavarësisë nga

Madagaskari

# (Mos) Transparenca në qeverisje

Në një shoqëri demokratike, Transparenca në qeverisje është kyçe për të siguruar qeverisje të mirë dhe llogaridhënie të duhur. Nëse qytetarët nuk janë të informuar si duhet rreth veprimeve dhe vendimeve të qeverisë, është e pamundshme që ata ta mbajnë llogaridhënese një qeveri të tillë. Për fat të keq, kjo çështje ka qenë gjithmonë problematike në Kosovë. Tradicionalisht Qeveria ka qenë larg arritjes së transparencës së plotë për publikun për një varg çështjesh, siç janë kontratat, marrëveshjet, emërtimet e zyrtarëve publikë, madje edhe arsyetimet.

Në këtë drejtim, Qeveria e re nuk ka shënuar ndonjë përparim të madh në krahasim me qeveritë e kaluara. Ndonëse shumica e dokumenteve të rëndësishme mund të gjenden në uebfaqet zyrtare, ekzistojnë lëshime të mëdha. Disa sosh të rëndësishëm si Programi Qeveritar, që besohet të jetë si gurthemel i veprimeve qeveritare, nuk mund të jenë të qasshme arsyeshëm, përveç me kërkesë, siç ndodh tash. Në përgjithësi Qeveria u përgjigjet kërkesave të tilla, porse ajo ka marrë një qëndrim kryesisht pasiv.

Veç kësaj, arsyetimi i vendimeve ende mbetet krejtësisht i shpërfillur. Ndonëse të gjitha dokumentet zyrtare pritet të përmbajnë një shpjegim pas vendimeve të marra, ky është thjesht formalitet. Vendimet nuk përmbajnë ndonjë shpjegim të arsyeshëm pas veprimeve të tilla, përveç një katalogu të veprimeve ligjore në të cilat institucioni e mbështet autoritetin e vet. Një model i tillë, i ushtruar edhe nga administratat e tjera, është në kundërshtim me parimet e transparencës dhe llogaridhënies të cilat janë thelbësore për një demokraci funksionale.

Në këtë aspekt, Qeveria nuk është krejtësisht transparente rreth politikave të emërimeve qoftë për këshilltarë politik ose për zëvendësministra. Këto dy kategori përmbajnë më se 100 zyrtarë publik statusi i të cilëve është i paqartë. Lidhur me të parën, deri më tash janë identifikuar 71 këshilltarë. Megjithatë, 7 ministritë nuk ofrojnë informata rreth kësaj çështjeje, përfshirë edhe Zyrën e Kryeministrit. Për më tepër, edhe ata që janë identifikuar si duhet, sërish roli dhe ekspertiza e saktë e tyre mbetet e paqartë në të gjitha rastet, pasi që asnjë e dhënë nuk është bërë publike. Sa për të fundit, informacionet në dispozicion nënkuptojnë se aktualisht ka mbi 67 zëvendësministra. Vetëm 56 prej tyre janë listuar publikisht nga ministritë përkatëse, ndërsa 4 ministri (e Drejtësisë, për Integrim Evropian, për Mjedis dhe Inovacion) nuk kanë dhënë kurrfarë informatash, duke lënë 11 persona të paidentifikuar brenda ministrive të lartpërmendura. Në këtë peizazh, fakti se disa ministri, gati një e treta e tyre, ofrojnë të paktën ca informacione elementare rreth përgatitjes së tyre dhe fushës së përgjegjësisë, mbase mund të konsiderohet si një zhvillim pozitiv. Një e treta tjetër thjesht kanë refuzuar të ofrojnë informacione përderisa një e treta e mbetur janë përgjigjur pjesërisht. Për fat të keq, mënyra e vetme për të mësuar emrat e gjithë listës së zëvendësministrave është duke shqyrtuar formularët e tyre të deklaramit të pasurisë të publikuar nga Agjencia kundër Korrupsionit.

## Vërejtje të përgjithshme

Në përmbyllje, më shumë se 3 muaj pas riorganizimit të departamenteve pas formimit të qeverisë, në të cilën u krijuan dy ministri të reja, prej tyre vetëm njëra, ajo për Zhvillim Rajonal ka një uebsajt funksional, ndonëse shumë bazik. Asnjë vendim rreth emërimeve të zëvendësministrave nuk është bërë publik deri më tash, gjë që të bën të mendosh për mungesë transparence gjatë gjithë procesit. Veç kësaj, një varg dokumentesh të cilat janë kërkuar pareshtur nga Shoqëria Civile ende nuk janë treguar. Qeveria Haradinaj nuk ka ndërmarrë hapa gjatë 100 ditëve të para të saj për të publikuar dokumentet zyrtare të cilat janë mbajtur me vite, siç janë Memorandumi për Homologim të Automjeteve, kontratat për ndërtimin e autostradave dhe, mes tjerash, edhe listat e bizneseve të cilat kanë përfituar nga falja e borxheve.

# Përfundimi

Haradinaj ka dhënë premtime të mëdha për 100 ditët e tij të para kur erdhi në pushtet, dhe siç ndodh zakonisht me premtime të tilla, ai ka dështuar që t'i përmbushë ato. Tre muaj nën drejtim të tij, udhëtimi në BE ende kërkon dokumente të shumta për ta siguruar një vizë - nëse keni fat ta merrni një, punëtorët dhe pensionistët ende orvaten ta sigurojnë jetesën dhe se rebusi i Trepçës ende mbetet i pazgjidhur.

Veç kësaj, kanë dalë edhe probleme të reja, jo nga faktorët e jashtëm ose rrethanat e paparashikuara, por nga vetë mënyra si Kryeministri është i prirë t'i kryejë punët e tij. Menaxhimi i çështjes së Demarkacionit ka pasur mungesë të drejtimit të qartë ose strategjisë. Pasi që kishte qenë si kritikuesi më i zëshëm i këtij dokumenti, ai e zëvendësoi Komisionin në kundërshtim me ligjin për të paraqitur një raport që i përshtatej më mirë, por pastaj ishte i shtyrë ta injoronte të tërin dhe ta pranonte se Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëse Mali i Zi ftohet në takim prapë.

Ai e ka anashkaluar Kuvendin dhe proceset e parapara për shkarkim të njerëzve të cilët mund të shkarkohen vetëm nga Kuvendi për ta fituar ndonjë titull të mirë në gazeta, por sundimi i ligjit vështirë se mund të arrihet pa respektuar ligjin. Përkundrazi, veprimet e Qeverisë së tij veçse e kanë dobësuar edhe më tej. Qeveria vazhdon të marrë vendime iracionale dhe të nxituara edhe pas 100 ditëshit të parë, që demonstron me vendimin për rritje qesharake të pagave të Kryeministrit, zëvendëskryeministrave, ministrave, mes tjerëve, edhe zëvendësministrave.<sup>36</sup>

Ministrinë vazhdimisht dështojnë të përmbushin atë që është premtuar. Programi i parë legjislativ i kësaj Qeverie është përmbushur vetëm pjesërisht, deri në njëfarë shkalle të ulët dhe se thuajse asnjë nga propozimet e tyre nuk janë miratuar nga Kuvendi, duke lënë shumë çështje në pritje të zgjidhjes. Deri më tash, mandati i Haradinajt mund të përshkruhet si vërtitje por pa rezultat.

36 Vendimi i Qeverisë nr. 04/20, 20 dhjetor 2017. Në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_20.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_20.pdf)

# 100 ditët e para

21

ministri

70+

zëvendësministra

71

këshilltarë

100+

zyrtarë publik

## rritje e pagave

të Kryeministrit, zëvendëskryeministrave,  
ministrave dhe zëvendësministrave

## Vërtitje, pa rezultat



Vlerësimi i

# 100 ditëve të para

të Qeverisë



Group for Legal  
and Political  
Studies



INSTITUTI GAP

INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY  
INSTITUTI PER POLITIKA ZHVILLIMORE

